

NE E ZGJEDHIM  
SYSTEMIN TONË TË  
QE VERISJES

DEMOKRACIA



PO



JO

# DEMOKRACIA NË VENDIN TONË

TEA (12), ARTAN (13), NITA (12), VALZA (13), ADI (12), ENDRIT (12)



## Në këtë artikull do të flasim për demokracinë në vendin tonë

Liritë dhe të drejtat e çdo fëmije, të rritur apo të mos-huar duhet të respektohen. P.sh. e drejta e lojës, e shkollimit, etj. Të drejtat janë të barabarta, nuk dallojnë nga raca, feja apo gjinia.

Ne jetojmë të lirë, kemi të drejtën e mendimit lirshëm, të shprehurit lirshëm, p.sh. nëse ne mendojmë ndryshe nga mendimi i të tjerëve kemi të drejtë të shprehemi pa marrë parasysh gjykimet e të tjerëve, kështu që prapë se prapë duhet të shprehemi. Rregullat duhet të respektohen, ligjet duhet të respektohen dhe zbatohen. Ne kur i mbushim 18 vjet kemi të drejtën e votimit. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja, ajo do të thotë „demos“ popull dhe „kracia“ udhëheqje. Demokracia në Greqi ka filluar që nga viti 507 para erës sonë. Ne po ashtu, kemi lirinë e lëvizjes, nuk kemi orë policore sepse tani nuk ka ndonjë gjë të tillë por ka

liri, demokraci dhe drejtësi.

Në Kosovë ka edhe qytetarë që nuk janë shqiptarë, ka edhe komunitete të tjera por sikurse shqiptarët ata kanë të drejta të barabarta.

Demokracia është duke u zhvilluar në vendin tonë. Të gjithë duhet të mundohemi për demokracinë, që të kemi një të ardhme më të mirë.



Elementet kryesore të demokracisë



Ky vizatim tregon për zemrën e demokracisë



Grupi i gazetarëve

# ZGJEDHJET NË NJË SHTET DEMOKRATIK


ADEA (12), ALTINA (12), ERNESA(12), ARDIANA (12), SHYQËRI (13), DIONIS (12), GËZIM (13)

## Rëndësia e pjesëmarrjes në zgjedhje


Zgjedhjet janë një proces i rëndësishëm i një shteti. Me anë të zgjedhjeve i zgjedhim përfaqësuesit e shtetit tonë. Detyra e tyre është të mbajnë premtimet të cilat ia kanë dhënë popullit. Çdo person mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtë të votoj, sepse konsiderohet si i/e pjekur, po ashtu edhe të burgosurit kanë të drejtë të votojnë. Në Republikën e Kosovës kemi dy lloje të zgjedhjeve: qendrore dhe lokale. Në zgjedhjet qendrore i zgjedhim përfaqësuesit e shtetit e që janë deputetët, kurse në zgjedhjet lokale i zgjedhim asambleistët dhe kryetarin e komunës. Secili qytetar i Kosovës duhet të votoj sipas mendimit të tij/saj dhe pa imponime, sepse vetëm një votë e jona mund të bëjë ndryshime. Prandaj, zgjedhjet janë pjesë e sistemit demokratik, sepse secili e ka të drejtën e shprehjes së mendimit të lirë.



Votuesit e së ardhmes



Zgjedhjet në Republikën e Kosovës



Secili qytetar e ka të drejtën e votës




Ndryshimi vjen nga populli



Vota është e fshehtë


## DETYRAT DHE FUNKSIONET E KUVENDIT

ANISA (12), AMINA (12), QENDRIM (12), GENTRIT (12), LEONART (12), VIGAN (13), ELDON (12)



**Në Kuvendin e Republikës së Kosovës bëhen plane për të mirën, të tashmen dhe të ardhmen e vendit tonë. Ne mendojmë se kjo është një gjë shumë e mirë**

Kuvendi është „Shtëpia e popullit“ aty kuvendohet. Kuvendi ndryshe quhet Pushtet Legjislativ, sepse aty bëhen ligjet. Përveç detyrës për të krijuar ligje si detyra të tjera të Kuvendit janë zgjedhja e Qeverisë, po ashtu Kuvendi kontrollon Qeverinë dhe mund ta shkarkoj atë nëse nuk punon mirë. Detyrë tjetër e Kuvendi është ta zgjedh Presidentin si dhe mund ta shkarkoj atë. Siç e kemi përmendur më lart, Kuvendi është pushtet legjislativ, do të thotë se ka funksion legjislativ sepse i bën ligjet. Funksioni tjetër i Kuvendit është kontrolues sepse kontrollon Qeverinë, dhe funksioni përfaqësues sepse e përfaqëson popullin. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë qytetarë shumicë, kurse 20 prej tyre janë nga



**Kuvendi i Republikës së Kosovës**

komunitetet jo shumicë. Qytetarët shumicë janë shqiptarë dhe komunitetet jo shumicë janë serbët, turqit, romët, boshnjakët, etj. Deputetët zgjedhen me votën e popullit, të cilat i fitojnë gjatë zgjedhjeve qendrore. Për të marrë pjesë në një proces zgjedhor duhet t'i kemi mbi 18 vjet.

Populli zgjedh deputetët, deputetët e përfaqësojnë popullin dhe ata janë zëri i popullit.



**Gazetarët duke punuar artikullin**



**Gazetarët e Kuvendit**

# NDARJA E PUSHTETIT NË DEMOKRACI

ARTA (12), ANISA (12), ARDIT (12), ENSAR (12), ARIANIT (12), ALBIONI (12), ÇLIRIMI (12)

**Sot kemi mësuar se si bëhet ndarja e pushtetit në një vend demokratik dhe sa e rëndësishme është ajo**

Në Kosovë si vend demokratik që është, pushteti ndahet në tri pjesë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor.


Pushteti legjislativ miraton ligjet të cilat propozohen nga deputetët dhe nga Qeveria. Këto ligje zbatohen nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Ne e kemi edhe pushtetin ekzekutiv që udhëhiqet nga Qeveria. Qeveria përbëhet nga ministritë të cilat udhëhiqen nga Kryeministri. Ministritë mund të jenë të ndryshme si: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Artit, Kulturës dhe Sportit. Kemi edhe Pushtetin Gjyqësor që ushtrohet nga gjykatat, e ato ndahen në: Gjykata Themelore, e Apelit dhe Supreme. Gjykata Themelore shqyrton problemet më të vogla. Gjykata e Apelit shqyrton problemet pak më të mëdha, si dhe Gjykata Supreme e cila merret me probleme shumë më të mëdha.

Funksionet e Kuvendit janë:


Përfaqësues, kontrollues dhe legjislativ. Funkzioni përfaqësues sepse përfaqëson popullin, kontrollues sepse kontrollon punën e qeverisë dhe legjislativ sepse mund të propozoj dhe miratoj ligje.




Ne jemi gazetarët e Kuvendit të Kosovës




Pushteti ndahet në tri pjesë siç shihet në foto



Funksionet që i kryen njëri prej pushteteve në Kosovë



Me anë të votave zgjedhen përfaqësuesit tanë



Ndarja e gjykatave



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë